



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 10.05.2022, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Arianit Beqiri (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Triera Kasumi-Berisha (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Berat Lahu (LVV), Berna Saraçi (LVV), Rita Zariqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Liridon Selmani, (PDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkyretar i Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkyretare e Komunës, Bersant Beka, drejtës i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtës i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiku, drejtës i Drejtorisë së Urbanizmit, Krenar Xhaferi, drejtës i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Adelina Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Izet Sadiku, drejtës i Drejtorisë së Shëndetësisë, Florian Dushi, drejtës i Drejtorisë së Inspeksionit, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Granit Rugova, drejtës i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Plator Gërdovci, drejtës i Drejtorisë së Bujqësisë, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të KFOR-it, dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Fehmi Kupina**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, kryesuesi konstatoi se në sallë janë prezent 48 anëtarë të Kuvendit. Pasi që u konstatua kuorumi, hapi diskutimin për rendin e ditës.

Fatos Dibra tha se me kërkesë të ekzekutivit të Komunës, tërhiqen nga rendi i ditës pika e tretë, "Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomëve në Prishtinë", pika e shtatë, "Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane" dhe pika e dhjetë, "Propozimvendimi për lënien në diskutim publik për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01 nr. 35-94056, dt. 04.05.2015, të Planit rregullues "Arbëria 3".

Përparim Rama, kryetar, propozoi që në rend të ditës të futet pika, "Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës "The Sunny Hill", SHPK". Lidhur me këtë propozim ceku se, qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është zhvillimi i mëtutjeshëm i festivalit "Sunny Hill", sigurimit të mbarëvajtjes së festivalit dhe kushteve optimale për rritjen e festivalit.

Elmira Nikçi-Rexha, propozoi që në rend dite të futet pika, "Propozimvendimi për subvencionimin e ndërmarrjes "Sport Marketing".

Gëzim Sveçla, lidhur me propozimin e kryetarit, z. Përparim Rama, kërkoi që pika e propozuar të mos futet në rend dite, për shkak se dokumentacioni nuk është i plotësuar, nuk është i kompletuar dhe, përvèç se nuk kemi informata të mjaftueshme jemi shumë të bindur që pastaj kjo do të shpallet e pavlefshme tek organi shqyrtues. Po ashtu, ceku se në këtë mbledhje është dashtë të jetë si pikë edhe, "Shqyrtimin e opinionit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për caktimin e lokacionit për strehimine kafshëve, pra është dashtë të jetë si plotësim-ndryshim i atyre kërkesave të cilat janë bërë nga Ministria dhe të kalojë tutje. Gjithashtu, propozoi që si pikë në rendin e ditës të jetë edhe "Anulim i vendimit për plotësim-ndryshim të Rregullores komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, nr. 110-2782, dt. 02.12.2011, i marrë nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e dt. 09.10.2017", e që konkretisht bëhet fjalë për taksën në transaksion.

Sami Boroci tha se çështja për "Sonny Hill" është një vendim që e kemi votuar edhe në mandatin e kaluar, por edhe në mandatin e kaluar e kemi votuar në mungesë të materialit të plotë. Propozoi që kjo pikë të zhvendoset për seancën e ardhshme, të kompletohet materiali, që të kompletohet dosja dhe të mos ketë kthim mbrapa më nga Ministria ose nga kushdo tjetër.

Sa i përket propozimit të znj. Rexha, për subvencionimin e NPL "Sport Marketingut", është një problematikë që po na përcjell me vite të tëra. Unë unë nuk jam kundër subvencionimit të kësaj ndërmarrjeje, mirëpo mendoj se për këtë ndërmarrje duhet të ndërmarrim edhe hapa të tjérë krahas subvencionimit, që ndoshta duhet edhe ta realizojmë në këtë fazë. Kështu që kisha propozuar që në këtë seancë meqenëse ka ndërruar edhe Kuvendi komunal, do me thënë ka asamblistë që nuk janë pjesë në këtë mandat, pjesë e atij grupei punues, me e bërë plotësim-ndryshimin e atij vendimi, me e funksionalizur atë grup punues, i cili do të vijë me një propozim para ekzekutivit dhe para Kuvendit me e pa se si do të trajtohet në të ardhmen kjo ndërmarrje.

Lidhur me reagimin e disa qytetarëve të cilët ishin të pranishëm në sallën e Kuvendit, Përparim Rama, kryetar, kërkoi mirëkuptim nga ta, që mos ta pengojnë mbajtjen e seancës, kështu që lidhur me shqetësimet e shprehura nga ata, iu premitoi një takim të mundshëm pas orës 12.

Bahri Gashi tha se sa i përket propozimit për "Sunny Hill" festivalit, kjo nuk duhet të hyjë sot hiq në rend të ditës, kjo duhet të kalojë në një seancë tjetër, të na jepni kohë neve të përgatitemi, të shohim se a ka plan biznesi, të shohim njëfarë ideje se çka do të bëhet aty. Kërkojmë që të mos i ndërroni pikat, ose paraprakisht të informohemi me kohë.

Fisnik Osmani sa i përket propozimit për heqjen e taksës në transaksion, theksoi se ne si GP i LDK-së e kemi iniciuar më herët këtë propozim, andaj dhe jemi për një gjë të tillë, mirëpo kjo duhet të bëhet në një seancë tjetër, për shkak se duhet t'i japim kohë drejtorisë përkatëse që të bëjë analizën e saktë dhe të mos marrim ndonjë veprim ose ndonjë vendim në nguti, për shkak se mund ta dëmtojmë buxhetin e Komunës, respektivisht mund t'i dëmtojmë edhe projektet e kapitalit të Prishtinës.

Muhamed Selmani propozoi që mjetet e dedikuara për ndërmarrjen "Pastrimi", mos të shkojnë vetëm si ndarje, por të bëhet si shlyerje e obligimeve të cilat i ka Komuna e Prishtinës ndaj ndërmarrjes "Pastrimi", konkretisht ndaj objekteve që janë komunale si: shkollat, çerdhet, QKMF- të e të tjera.

Sa i përket çështjes së subvencionimit të ndërmarrjes "Sport Marketing", mendoj se duhet të rishikohet edhe njëherë shumë seriozisht statuti i saj dhe të shihet cila është mundësia e fuzionimit, apo shkrirjes në një ndërmarrje tjetër, konkretisht në ndërmarrjen "Pallati i Rinise", sepse aktivitetet janë pothuajse të ngjashme me këtyre ndërmarrjeve". **Nora Kelmendi** ngriti shqetësim rreth propozimit për tërheqjen e dy pikave të rendit të ditës: "Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomëve në Prishtinë" dhe " Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane".

Lidhur me çështjen e ngritur nga znj. Kelmendi, sqarime të nevojshme dhanë Valbona Makolli, drejtoreshë dhe Bersant Beka, drejtor.

Valbona Ajeti kërkoi të dijë se a ka ndonjë projekt për nënkalime dhe mbikalime në kryeqytet, ku kemi rrezikshmëri të lartë aty tek kalimi, si p.sh. tek "Albi Mall", te Rrethi i Flamurit, kështu që në mungesë të tyre kalimtarët po pësojnë me fatalitet.

Leutrim Retkoceri, propozoi që pika e parë e rendit të ditës të zhvendoset në pikën e shtatë, për shkak të harmonizimit të emrave me të gjitha grupet e tjera, sepse vendimi duhet të kalojë me propozimin e të gjitha grupeve që i kanë anëtarët.

Kushtrim Mushica propozoi që me rastin vdekjes së legjendës së boksit të Kosovës, Xhevdet Pecit, në shenjë nderimi të bëhet një minutë heshtje. Gjithashtu, që në një të ardhme të afërt të emërohet një rrugë në emër të legjendës.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna, si në vijim:

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 25 kundër, miratohet propozimi i kryetarit që "Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës "The Sunny Hill", SHPK", hyn në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 17 kundër, u miratua propozimi i z. Nikçi-Rexha, që "Propozimvendimi për subvencionimin e mjeteve financiare për NPL "Sport Marketing", të futet në rend të dirës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 24 kundër dhe 3 abstenime (por duke llogaritur votën e dyfishtë të kryesuesit, i cili votoi kundër), nuk u miratua propozimi i z. Sveçla, "Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për plotësim-ndryshimin e Rregullores Komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba Komunale, nr. 11012782, të dt. 02.12.2011, i marrë nga Kuvendi komunal në mbledhjen e dt. 09.10.2017", nuk hynë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 21 kundër dhe 1 abstenim, u miratua propozimi i z. Boroci, që "Propozimvendimi për themelimin e grupit punues për shqyrtimin e fushëveprimit të NPL "Sport Marketing", hynë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 18 kundër, u miratua propozimi i z. Retkoceri, që pika një e rendit të ditës, "Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës", të kalojë në pikën shtatë të rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 3 kundër, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Propozimvendimi për shfuqizimin e pjesërishëm të Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-0088887/20, i dt. 11.06.2020";
2. Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë";
3. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktiviteteve "3x3 Prishtina Fiba Challenger";
4. Propozimvendimi për subvencionimin e nënave lehona, përfituese të skemës sociale (për të porsalindurit e tyre)";
5. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA në Prishtinë";
6. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me projektrregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, të dt. 06.06.2018;

7. Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
8. Propozimvendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës "The Sunny Hill", SHPK";
9. Propozimvendimi për subvencionimin e NPL "Sport Marketing";
10. Propozimvendimi për themelimin e grupit punues për shqyrtimin e fushëveprimtarisë së NPL "Sport Marketing";
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

Pika e parë

Propozimvendimi për shfuqizimin e pjesërishëm të Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-0088887/20, i dt. 11.06.2020".

Lidhur me këtë propozimvendim në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Valbona Makolli, drejtoreshë.

Gëzim Sveçla tha se këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Donjeta Dragusha u shpreh se meqë forma e ndarjes së këtyre mjeteve ka qenë përmes programit të grandeve për biznese, do me thënë edhe të vetë të punësuarit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, i cili ka ndihmuar bizneset që të dëshmojnë humbjet e tyre nga masat restriktive të pandemisë, mirëpo pasi që disa prej tyre nuk kanë pasur dokumentacionin përkatës të kërkuar dhe disa të tjera me gabime, ne si grup sigurisht që e mbështesim këtë propozimvendim për shfuqizim.

Muhamet Selmani kërkoi të dijë shumën e sakët të mjeteve të shfrytëzuara, sa kanë qenë nga grantet dhe sa kanë tepruar. Kisha propozuar që mjetet të cilat kanë tepruar nga ky subvencionim të destinohen tanë për subvencionim ose në kulturë ose në sport.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Selmani, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtoreshë.

Valbona Ajeti tha se edhe ne si GP këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Gëzim Mehmeti tha se ky vendim është bazuar në atë kohë në rrethanat emergjente të cilat si shkak e kanë pasur pandeminë, ka qenë vendim i drejtë dhe tash rrethanat kanë ndryshuar dhe ne e përkrahim propozimin për miratim.

Endrit Zabërgja tha se edhe ne këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 34 vota për, u miratua Vendimi për shfuqizimin e pjesërishëm të Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-0088887/20, dt. 11.06.2020".

Pika e dytë

Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë.

Lidhur me Propozimvendimin për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Granit Rugova, drejtor.

Granit Geci tha se si grup parlamentar pa dyshim se e mbështesim këtë iniciativë për mbështetjen dhe ndarjen e mjeteve për subvencionimin të klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë. Kisha kërkuar nga ekzekutivi që, në një të ardhme jo të largët mundësish t'i mbështesim dhe t'i subvencionojmë edhe klubet tjera edhe sportistët e tjera, të cilët pa dyshim që çdo ditë po i sjellin Prishtinës shumë tituj.

Kushtrim Mushica tha se në emër të GP të AAK-së, sigurisht që e mbështesim këtë mbështetje të klubeve, por me shpresën që edhe në vitin e ardhshëm të bëhet edhe një mbështetje më e madhe për klubet tona përball klubeve të qyteteve tjera.

Sami Boroci tha se edhe ne e mbështesim këtë propozim-vendim për subvencionim të këtyre klubeve, por si ekzekutivi ashtu edhe Kuvendi, duhem me trajtuar pak më seriozisht punën e sportit, duke u nisur prej çështjes së rritjes së buxhetit, e ky buxhet me qenë i orientuar një pjesë të madhe në infrastrukturë, sepse Prishtina në të gjitha sportet është duke u rritur, duke u zhvilluar.

Endrit Zabërgja tha se edhe ne po ashtu e përkrahim subvencionimin e klubeve tradicionale të kryeqytetit, të cilët na kanë bërë krenar dhe njëkohësisht besojmë se duhet të angazhohemi në të ardhmen, të krijomë linja të reja buxhetore për subvencionimin, në veçanti të ekipeve të reja që kanë potencial zhvillimi, duke i motivuar të rinjtë që të merren me sport.

Kryesuesi konstatai se më 48 vota për dhe 2 kundër, u miratua Vendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë.

Pika e tretë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktiviteteve "3x3 Prishtina Fiba Challenger".

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Granit Rugova, drejtor.

Gëzim Sveçla, në emër të GP të LVV-së, tha se këtë propozimvendim e mbështesim për miratim.

Jeta Rafuna -Hasani theksoi se edhe ne si GP do ta përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Fatmir Dervishi tha se grapi i asamblistëve të PDK-së e përkrah këtë propozimvendim, pra duke i dhënë një përkrahje të rinisë dhe sportit kosovar, mirëpo kërkojmë nga organizatorët të menaxhohet sa më mirë dhe të kryhen punët ashtu siç janë të planifikuara.

Endrit Gashi, në emër të GP të AAK-së, tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Sami Boroci tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim, si një aktivitet tradicional që është, edhe aktivitet me karakter sportiv dhe kulturor.

Endrit Zabërgja tha se e përshëndesim këtë propozimvendim pér miratim, duke e pasur parasysh që është mjaft i veçantë dhe urojmë që edhe në të ardhmen të jetë i tillë.

Sami Salihu tha se me padurim e kemi pritur këtë aktivitet dhe e presim ne si rini pér shumë vite, por e kam një pyetje pér drejtorin, se në çfarë forme kriteri është shpallur fituese kjo OJQ pér organizim, a ka pasur ndonjë konkurs apo konkurrencë.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Salihu, sqarime shtesë dha Granit Rugova, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 49 vota pér dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi pér ndarjen e mjeteve pér organizimin e aktiviteteve "3x3 Prishtina Fiba Challenger".

Pika e katërt

Propozimvendimi pér subvencionimin e nënave lehona, përfituese të skemës sociale (pér të porsalindurit e tyre).

Pér këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Premtim Fazliu, përfaqësues nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale.

Violeta Salihu- Emini tha se ky subvencionim nga ana e Komunës do të forcojë edhe më tej vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, më konkretisht Vendimin pér pagesat pér lehonat dhe shtesave të fëmijëve të pakos së ringjalljes ekonomike. Ne si grup parlamentar i LVV-së, dëshirojmë të dimë se ky subvencionim a do të ketë kontinuitet, apo është menduar vetëm pér një kohë të caktuar, por mendojmë se duhet të caktohet një strategji e cila do ta zgjerojë skemën e subvencionimit dhe pér gratë e papuna që gjinden në një situatë jo të mirë financiare që nuk janë të përfshira në skemën sociale.

Lindita Rexhepi tha se edhe ne si GP e përkrahim këtë propozimvendim pér subvencionim, sepse është njëri prej vendimeve më të mira që mundet me qenë në vendimet të cilat rrjedhin nga Komuna e Prishtinës.

Kumrije Shabani - Ramadani tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim sikur se në të kaluarën që kemi përkrahur propozime të tillë. Është një iniciativë shumë e mirë, veçanërisht pér përkrahjen e nënave lehona, të cilat deri më tanë nuk kanë përfituar një ndihmë të tillë, por si kërkesë e grupit tonë është që në të ardhmen, në rishikimin e buxhetit të rishikohen dhe të subvencionohen edhe nënët tjetra të cilat nuk janë të kategorisë sociale.

Valbona Ajeti tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë subvencionim të nënave lehona, edhe pse nuk është e një qëndrueshmërie të lartë kjo shumë, por duke marrë parasysh ngritjen e të gjitha çmimeve, besoj që është një ide shumë e qëlluar.

Sami Boroci tha se edhe ne këtë propozimvendim natyrisht që e mbështesim, është ide shumë e qëlluar, që kjo kategori duhet të subvencionohet, në fakt përherë të parë po bëhet

kjo. Ai kerkoi nga zyrtari i drejtorise përkatëse se a ka ndonjë kalkulum, ndonjë kosto orientuese financiare vjetore e Komunës.

Endrit Zabërgja tha se po ashtu edhe Nisma duke qenë parti politike e orientuar në krahun e majtë, duke qenë parti politike social demokrate përshtendet dhe inkurajon që të vazhdohet me politika të tilla sociale ku përfitues do të jenë në veçanti ata të cilët kanë nevojë, mirëpo besoj që në të ardhmen duhet të trajtohen jo vetëm të posalindurit, por në veçanti fëmijët që shquhen për talent që vinë nga këto familje me kushte të rënda.

Fiknete Bejta tha se propozimi i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale është propozim me vend edhe në mandatin e kaluar kemi diskutuar për mundësin e subvencionimit të të gjitha lehonave, mirëpo me një paralogaritje ka dal që mund të tejkaloj një shifër që pastaj nuk mund të jetë i përballueshëm për Kuvendin Komunal. Mirëpo si propozimvendim është shumë i qëlluar dhe duhet ta përkrahim të gjithë.

Berat Lahu tha se çështja e subvencionimit të fëmijëve të posalindur, mendoj se nuk është mirë e specifikuar me fëmijë edhe realisht i bie që nëse një nënë lind binjak përfiton vetëm 500 euro, mendoj që janë tepër pak para që me qenë kaq dorështrënguar, kështu që propozoj kjo të bëhet për fëmijë të lindur dhe jo për nënët që lindin.

Lidhur me çështjet e ngritura rreth këtij propozimvndimi nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Prentim Fazliu, përfaqësues nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 47 vota për, u miratua vendimi për subvencionimin e nënave lehona, përfituese të skemës sociale (për të porsalindurit e tyre).

Pika e pestë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë

Lidhur me Propozimvendimin për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë, në pikë të shkurtë të pranishmit i informoi Alban Zogaj, nënkyetar.

Berat Lahu tha se sa i përket këtij propozimvendimi për ndarje të mjeteve financiare KRM "Pastrimi", ne jemi kundër financimit të borxheve, është kundër çdo logjike ekonomike, prandaj kërkojmë nga kryetari Rama që të ndërmarrë masa ndaj menaxhmentit të kësaj ndërmarrje, pra të jetë një menaxhment i ri dhe një bord profesional i ri dhe vota jonë do të jetë pro ndarjes së mjeteve.

Fiknete Bejta tha se ne si grup i asamblistëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim ketë subvencionim. Mendojmë që duhet të ndahet operativa nga menaxhmenti dhe ndërmarrjen nuk mund ta lëmë në kushte të tilla, për shkak të një borxhi që i ka deponisë sanitare në Mirashi. Prandaj, në ketë fazë ne duhet ta përkrahim, subvencionojmë ndërmarrjen për pagesën e tillë, në mënyre që mos të bllokohet procesi i mbledhjes së mbeturinave.

Leutrim Retkoceri theksoi se sa i përket propozimit për subvencionimin e borxhit të ndërmarrjes rajonale "Pastrimi", nuk është hera e parë që po vjen një propozim i tillë, kemi pasur propozime edhe më herët, mirëpo për gjendjen në ketë ndërmarrje,

nuk ka nevojë shumë të flasim se gjendja nuk është e mirë, prandaj për tejkalimin e gjendjes duhet të ndihmohet me mjete financiare.

Bahri Gashi, në emër të GP të AAK-së, përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi.

Sami Boroci tha se ideja është që me ndërmarr hapa sa më të shpejtë, që këto ndërmarrje të bëhen ndërmarrje funksionale profitable dhe me e ofruar shërbimin për të cilin janë të thirrura, por kjo ndërmarrje e ka edhe një problem tjetër. Pasi që është ndërmarrje rajonale dhe e ka vetëm një anëtar të bordit, ku zakonisht menaxhimi në ketë ndërmarrje ose vendimmarrja në ketë ndërmarrje ka qenë përmes anëtareve të bordit të komunave tjera, si Fushë-Kosova, Lipjani, Drenasi, ose ndonjëra prej tyre dhe anëtari i Prishtinës gjithmonë ka qenë minor.

Gëzim Sveçla theksoi se do të ishte mirë që të fillojmë me procedurat e nevojshme, që mos të varemi nga komunat tjera regionale. Ne si LVV jemi të gatshëm të ofrojmë ndihmë tonë në çfarëdo aspekti në ketë drejtim, që ka të bëje me përmasimin e gjendjes shumë të vështirë dhe shumë të rënd në aspektin e mbeturinave.

Endrit Zabërgja shprehu mendimin se ky propozimvendim është obligim, i cili na obligohet për shkak se asnjeri prej neve nuk duam që qyteti ynë me u bllokuar e mos më pasur deponi të mbeturinave, prandaj dhe kjo qaseje me lëmosha të përkohshme e mbështet një ndërmarrje të caktuar, por besoj që duhet me filluar më përfunduar. Urojë që kjo të jetë e fundit në ketë mënyrë. Konsideroj që ndërmarrja "Pastrimi" duhet të jetë njëra nga ndërmarrjet e para që të merremi me problemet e saj.

Muhamed Selmani, në cilësinë e aksionarit të ndërmarrjes "Pastrimi", tha se është një borxh i trashëguar nga viti 2000 – 2013 dhe si pasojë kanë mbetur edhe këto borxhet e trashëguara për të cilat folëm.

Ndërmarrja deri më tani ka arritur të fshijë borxin si pasojë e pandemisë, pastaj dhe humbja që është shkaktuar nga pandemia ka ndikuar në ngecjen e pagesës së borxhit. Pa dashur të lëshohemi në procedurat e mira, sepse ende nuk kemi shumë ndërmarrje për me e parë sakte së cili është niveli dhe situata e ndërmarrjes. Ne disa herë kemi pasur takime me kryetarin dhe nënkyetarin, ku është kërkuar që të bëhet një zgjedhje për të fshirë borxin që e kemi ndaj kompanisë për menaxhimin e deponive të mbeturinave në Kosovë.

Ai ftoi të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta përkrahin këtë propozimvndim se është më se i domosdoshëm.

Gëzim Mehmeti tha se nuk do të ketë zgjidhje derisa Prishtina ta ketë të pavarur ndërmarrjen publike "Pastrimi". Derisa në bord ekzistojnë edhe komunat tjera, ia pamundësojnë Komunës së Prishtinës të ketë shumicën, d.m.th. ne nuk e kemi shumicën në bord, po ashtu edhe vendimet që merren në ketë rast sa i përket çështjeve të ndryshme ekzekutive, në legjislativ janë thuajse të pamundura.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Alban Zogaj**, nënkyetar.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, 14 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi pér ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi pér konsulta paraprake publike lidhur me projektrregulloren pér ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores pér organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, e dt. 06.06.2018.

Për këtë propozimvendim, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Bersant Beka, drejtor.

Feim Osmani, në emër të GP të LVV-së, tha se edhe ne e kemi shqyrtuar këtë projektrregullore, duke i evidentuar disa mangësi tek disa nene dhe paragrafë të tyre, si në nenin 4, paragrafët 4.3, 4.8, neni 6, neni 5, paragrafët 5.8, 5.13, kështu që kërkojmë që këto nene – këta paragrafë të këtyre neneve të korrigohen dhe të plotësohen, me qëllim që rregullorja të jetë më funksionale. Mendoj se propozimet që i dhamë i kemi shqyrtuar dhe analizuar, që nuk bien ndesh me Udhëzimin administrativ, mirëpo kishte me qenë mirë që gjatë diskutimit publik të plotësohet dhe të vijë në Kuvend.

Elmira Nikçi- Rexha u shpreh se edhe ne e kemi shqyrtuar ketë plotësim-ndryshim të rregullores dhe mendojmë se kjo do të jetë funksionale dhe në përputhje më Udhëzimin administrativ. Si Grup parlamentar e votojmë miratimin e kësaj rregulloreje pér procedura të mëtejme.

Leutrim Retkoceri tha se edhe Grupi ynë parlamentarë e ka shqyrtuar këtë projektrregullore, e që propozimet dhe rekomandimet do t'i përcjellim gjatë diskutimit publik.

Kushtrim Mushica tha se edhe ne si Grup parlamentar e mbështesim këtë projektrregullore pér diskutim publik.

Sami Boroci tha se me qenë se kjo projektrregullore del në diskutim publik, do ta mbështesim, ku propozimet dhe rekomandimet tona do të mundohemi t'i japim gjatë diskutimit publik, por edhe në seancën e fundit kur miratohet kjo rregullore.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga z. Osmani, sqarime të nevojshme dha Bersant Beka, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 46 vota pér dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi pér konsulta paraprake publike lidhur me projektrregulloren pér ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores pér organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, dt. 06.06.2018.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Gëzim Sveçla, për anëtarë të komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës, propozoi: Për Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Arbër Vokrrin, për Komitetin për Arsim, Berna Saraçin, për Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport, Rita Zeqirin, për Komiteti për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Arianit Beqirin, për Komitetin për Shërbime Publike, Berat Lahun, Besnik Mujecin dhe si përfaqësuese jashtë asamblesë, Diellza Namanin, për Komitetin për Pronë dhe Kadastër, Ermal Osmanin dhe Rinë Zhitinë, për Komitetin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Feim Osmanin dhe Rashit Gashin, për Komitetin për Barazi Gjinore, Violeta Salihun, Besart Krasniqin dhe Leonora Shabni-Bajraktarin, e jashtme.

Jeta Rafuna - Hasani, për anëtarë të komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës, propozoi: Për Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Fiknete Bejtën, Mimoza Xhaka - Bllacakun e jashtme, për Komitetin për Arsim, Ajet Brajshorin dhe Lendita Rexhepin, për anëtarë të komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës, propozoi: Për Komitetin për Planifikim Urban Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Pëllumb Bajqinofcin dhe Amir Simnicën, për Komitetin për Shërbime Publike, Dasmor Durmishin, për Komitetin për Pronë, Sami Salihun dhe Agim Kuletën, për Komitetin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Driton Rukiqin dhe Besë Prestreshin e jashtme dhe për Komiteti për Barazi Gjinore, Dhurata Jaha - Retkocerin.

Leutrim Retkoceri për anëtarë të komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës, propozoi: Për Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dok. Liridon Selmanin, për Komiteti për Arsim, prof. Fatmir Dervishin dhe Xhylbeha Llapin, e jashtme, për Komitetin për Kulture Rini dhe Sport, Gresa Lahun, për Komitetin për Planifikim Strategjik Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Rozeta Fetahun, e jashtme, për Komitetin për Shërbime Publike, Granit Gecin dhe për Komitetin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Muhamet Selmanin.

Kushtrim Mushica, për anëtarë të komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës, propozoi: Për Komitetin për Kulturë Rini dhe Sport, Valbona Ajetin dhe Adelina Mehuni, e jashtme, për Komitetin për Shëndetësi, Taulant Maxharrën, për Komitetin për Pronë, Endrit Gashin.

Gëzim Mehmeti, për anëtarë të komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës, propozoi: për Komitetin për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Sami Borocin dhe për Komitetin për Barazi Gjinore, Besnik Bahtirin, i jashtëm.

Endrit Zabërgja, për anëtarë të komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës, propozoi: për Komiteti për Kulture Rini dhe Sport, propozoi veten (Endrit Zabërgjën).

Me propozimet e dhëna, Kryesuesi konstatoi se më 45 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e tetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës.

Lidhur me këtë propozimvendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku.

Nora Kelmendi tha se në dokumentacionin e pranuar nga ekzekutivi është bashkangjitur certifikata e pronës, kopjet e planit dhe kërkesa e "Suny Hill" nga personi i autorizuar, e cila është e vitit 2020, si dhe një marrëveshje të arritur pas negocimit të ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për kompaninë private "Suny Hill". Sa i përket marrëveshjes ajo është bërë nga personi i autorizuar, mirëpo autorizimi nuk është i noterizuar. Gjithashtu, duhet të përmendet edhe certifikata e biznesit, të cilën e kemi pranuar sot, nuk ka person të autorizuar, dhe vërtetimin që nuk ka obligime tativore, të cilat i ka skaduar afati. Po ashtu edhe qarkullimin bankar për vitin paraprak nuk e kemi pranuar. Pra të gjitha këto dokumente duhet t'i bashkëngjiten, në mënyrë që të procedojmë më tutje për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone.

Jeta Rafuna- Hasani tha se ne e kemi diskutuar si grup parlamentar dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim për "Suny Hill" në Bërnicë, dhe ne do ta votojmë këtë propozimvendim.

Leutrim Retkoceri tha se ne e përkrahim pikën e rendit të ditës për dhënien e pronës festivalit, apo "Suny Hill", por mendojmë që është hera e dytë që jemi duke proceduar me këtë pikë, dhe kjo po vjen si pasojë se në mandatin e kaluar nuk ka qenë i kompletuar dokumentacioni dhe është shpall i pavlefshëm ai votim. Mendoj se ky propozimvendim i plotëson kushtet që të hidhet në votim për miratim.

Bahri Gashi fillimisht ngriti një shqetësim rreth dhënies së kësaj prone në shfrytëzim për 99 vjet për një festival, për një biznes i cili performancën e ka këto vitet e fundit, mendoj se kjo nuk qëndron, kështu që në anën tjetër, 17 ha do të kishim pasur mundësi t'i ndërtojmë shumë stadiume dhe shumë hapësira tjera për sporte të cilat janë të përditshme etj. Do të ishte mirë që të shihet mundësia që me e kthyer këtë propozim mbrapa, me pasur mendësi me diskutuar pak më shumë për këtë çështje, që mos të procedohet në këtë formë.

Ai shprehu qëndrimin e subjektit politik, se GP i AAK-së nuk do ta votojë këtë propozimvendim.

Gëzim Mehmeti tha se si propozim biznesor e përkrahim, mirëpo gjërat po bëhen shumë me nguti që kriteret, kontrata lënë shumë për të dëshiruar. Në këtë aspekt kishte me qenë shumë më mirë që për interes të kësaj ngjarje, për interes të Komunës në këtë rast, të interesit publik, të lihet më shumë hapësirë, të kompletohet lënda dhe të diskutohet në njëren prej mbledhjeve të radhës.

Si GP i AKR-së, nuk do ta votojmë këtë propozimvendim.

Faqe12nga21

Gëzim Sveçla tha se sa i përket çështjes së marrëveshjes së negociuar me ofertuesin, mendoj se është një marrëveshje jo e favorshme për Komunën e Prishtinës, në fakt është komplet penalizuese për Komunën, duke filluar prej kohëzgjatjes 99 vjet për një hapësirë prej 17 ha. Në këto kushte me të vërtetë është e pamundur nga ne të votojmë, një pronë të qytetarëve të Prishtinës me ia dhënë një festivali.

Kërkojmë që kjo të kthehet mbrapa, të bëhet një marrëveshje më e kapshme, më të mirë, që është në interes të të dy palëve, të Komunës dhe të "Suny Hill". Na ftoni në seancë të jashtëzakonshme, në çdo kohë jemi të gatshëm me ardhur me votuar edhe me kaluar ky propozimvendim.

Petrit Reçica tha se nuk jemi që ajo parcelë t'i jepet një kompanie për 99 vjet, kështu që ne mendojmë se duhet t'i largojmë festivalet e tjera prej qytetit, t'i dërgojmë në këtë parcelë, se nuk ka parcelë më të mirë Prishtina për festivale. Pra, ne e kemi këtë kërkesë me pasur qasje edhe festivalet tjera në këtë parcelë.

Endrit Zabërgja tha se do të ishte mirë që t'i largojmë festivalet prej qytetit e t'i qojmë në këtë parcelë, se nuk ka parcelë më të mirë Prishtina për festivale, në stadium nuk mundemi me i shti se UEFA nuk na lë, na e tërheq licencën për futboll. Kështu që ne e kemi këtë kërkesë me pasur qasje edhe festivalet tjera në këtë parcelë, këtu kishim mundur me negociuar përnjëmend këtë marrëveshje.

Berat Lahu tha se dhënia e kësaj prone në shfrytëzim festivalit "Sony Hill" për 99 vjet, nuk qëndron, kështu e konsideroj si logjike atë se çka e propozuan kolegët e mi të tjerë, që me iu dhënë festivalit "Suny Hill" për dy muaj në shfrytëzim në kohën që ai e njofton në fillim të vitit, që thotë në muajin korrik dhe gusht, edhe atë nëse bënë investime të tilla, atëherë t'i lejohet për 10-15 vjet e jo 99 vjet, kështu që kjo është e paqëndrueshme edhe unë e votoj kundër.

Feim Osmani tha se sa i përket kësaj hapësire për dhënien në shfrytëzim, ne kemi mungesë të hapësirave publike për investime të tjera si institucione arsimore, shëndetësore etj. dhe shumë herë kemi mbetur pa investime të tilla në mungesë të pronës, ndërsa sot 17 hektarë po i japim për një festival për 99 vjet dhe nuk po i dimë tërësisht specifikat. Mendoj se do të ishte mirë që me e bërë një analizë të terrenit me disa ekspertë me e parcelizuar atë hapësirë, me e zvogëluar, sepse jam shumë i sigurt që kishte me qenë e mjaftueshme edhe gjysma apo një e katërtë e kësaj hapësire.

Triera Kasumi - Berisha, lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim për festivalin "Sony Hill", parashtroi dy pyetje: Sa është i gatshëm kryetari me i marr parasysh disa pika që ne po i propozojmë, ne e kemi një marrëveshje përpëra, është e vërtetë, por për derisa e kemi një marrëveshje të negociuar, e cila më vonë do të shndërrohet në kontratë, ne ishte dashur me e ditë se cilat pika paraqiten në atë kontratë, që me qenë shumë konkret në atë se çka po votojmë. Po ashtu, kërkoi të dijë se cilat kanë me qenë pikat dhe çka përbajnë ato pika të cilat paraqiten në kontratë, si arsyet që kjo marrëveshje mundet të ndërpritet me operatorin që është përfitues në këtë rast. **Muhamet Selmani** tha se ne po flasim për një investim që është disa milionësh, që munden me shkuar edhe dhjetëra milionësh, edhe vetëm fitimet e tij që vijnë 30%, besoj se mbulon 99 vjetshin e qirasë të tokës. Lidhur me këtë kisha propozuar që kjo

marrëveshje të bëhet me dy pjesë, të bëhet 20+40 ose 40+50 vjet, në bazë të projektit, e në çoftë se kjo nuk ndikon tek investitori, gjithmonë ne duhet të bëjmë gjithçka që ky projekt të mos guxojë të ikën jashtë Prishtinës.

Sami Boroci tha se duke pasur parasysh qëndrimin e opozitës për këtë propozimvendim, besoj se duhet me u marr parasysh prej ekzekutivit të paktën me e rimenduar nëse mundet kjo pikë me u sjellë në ndonjë seancë tjetër. Pra, ideja është që ne duhem edhe atë marrëveshje që ka me derivuar pas votimit të Kuvendit, me e strukturuar sa më mirë, me pasur hapësirë edhe kryetari, edhe drejtoria në këtë rast. Konsideroj se si çështje problematike është sasia e tokës prej 17 ha dhe afati i shfrytëzimit, e që kisha propozuar të jetë për 40 vjet. Duke pasur parasysh edhe diskutimet e parafolësve, do të ishte mirë që kjo pikë të shtyhet për ndonjërën nga seancat e radhës.

Arianit Beqiri tha se edhe ne në asnjë moment nuk jemi kundër "Suny Hill", pra ajo hapësirë mundet të përdoret si hapësirë multifunksionale e jo vetëm për një kompani, siç është "Sony Hill". Ajo hapësirë mund të jetë shumë atraktive për shfrytëzimin e garave të ndryshme me biçikleta, me motorë apo diçka tjetër, andaj dhe ne jemi të interesuar që kjo të diskutohet në një seancë tjetër, qoftë edhe në ndonjë seancë të jashtëzakonshme, mirëpo duhet ndryshuar këto pika.

Amir Simnica tha se duke besuar në vullnetin e mirë e gjithsecilit, ne si GP i LDK-së me partinë që jemi në koalicion, veç e kemi ndarë mendjen që ky projekt të ecën përpara.

Lidhur me vërejtjet dh sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Përparim Rama, kryetar, Doruntinë Maloku, drejtoreshë dhe fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore..

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, 19 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për subvencionimin e NPL " Sport Marketing",

Lidhur me këtë propozimvendim, Elmira Nikçi – Rexha tha se duke pasur parasysh gjendjen financiare të ndërmarrjes, e që kjo ndërmarrje operon më një aset siç është pishina e Gërmisë dhe si pasoj e pandemisë dhe situatës në të cilën kaluam të gjithë, pajtohemi të gjithë së kjo ndërmarrje është në gjendje të rëndë financiare, andaj propozoj që të ndahen mjetet në vlerë prej 150 mijë euro për ndërmarrjen "Sport Marketing".

Jeta Rafuna – Hasani, e përkrahim për miratim këtë propozimvendim.

Leotrim Retkoceri kërkoi të dijë se nga cila kategori ndahen këto mjete dhe a mundet të ekzekutohet subvencionimi, për ndryshe në dobi dhe në funksionalizimin e ndërmarrjes.

Bahri Gashi tha se edhe ne e përkrahim ketë propozim për miratim.

Faqe14nga21

Sami Boroci tha se do ta përkrahim për miratim këtë propozimvendim, por në pikën e radhës të rëndit të ditës, duhet bërë një grup punues, me i bërë zgjidhje kësaj ndërmarrje, që mos me vazhduar më subvencionuar në ketë formë.

Feim Osmani tha se pse ekziston kjo ndërmarrje kur e ka vetëm një aset të burimeve financiare dhe të aktivitetit, edhe ai aset është i përkohshëm, është sezonal, andaj duhet shikuar mundësinë që me i bërë zgjidhje tjetër.

Triera Kasumi - Berisha theksoi se padyshim që na duhet përkrahur idenë për subvencionim të pagave, por do të ishte mirë që të dimë se sa janë obligimet e pagave dhe sa janë obligimet për KEDS, Ujësjellësin dha ATK-në dhe për sa muaj ky subvencionim ka më e mbuluar operimin e kompanisë dhe kur parashihet që kjo kompani ka me pasur edhe asete të tjera.

Kryesuesi konstatoi se më 42 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për subvencionimin e NPL "Sport Marketing".

Pika e dhjetë

"Propozimvendimi për themelimin e grupit punues për shqyrtimin e fushëveprintarisë së NPL "Sport Marketing".

Lidhur me këtë propozimvendim **Sami Boroci** tha se ideja është që ta rifunksionalizojm atë grup punues, apo ta bëjmë një grup punues me përfaqësues të të gjitha partive që janë të përfaqësuara në Kuvend dhe me anëtarë të ekzekutivit. Detyra e këtij grupei punues do të ishte një punë vullnetare dhe të jep rekomandime, që kjo ndërmarrje të bëhet temë pak më e madhe brenda Komunës dhe të bëhet ndërmarrje profitable. Besoj se kjo ndërmarrje mundet të organizohet ndryshe, mundet me qenë ndërmarrje më profitable, ta ketë një domen shumë më të gjerë dhe mundet t'i ketë qoftë terrenet sportive, qoftë hapësirat reklamuese, qoftë shumëçka tjetër që ne mund ta subvencionojmë përmes buxhetit komunal për mirëmbajtjen e këtyre terreneve sportive.

Gëzim Sveçla tha se në fakt ky propozim për ta themeluar këtë grupin punues ne po e shohim si vendosje e një niveli të tretë brenda ndërmarrjes publike, e që është jashtë komplet logjikës me të cilën funksionojnë këto ndërmarrje publike, kur dihet se në ato ndërmarrje veç sa i kemi vendosur aksionarët dhe të njëjtit po e kryejnë punën e vet atëherë ne konsiderojmë që është e panevojshme të krijuhet një grup punues i tillë.

Leutrim Retkoceri tha se komisioni i cili ka qenë në mandatin e kaluar, mendoj se nuk është valid, mirëpo edhe ky komisioni i cili po propozohet të formohet konsideroi se është i ngutshëm. Mendoj që duhet të ju jepet pak kohë dhe besoj që në një të ardhme të afërt nëse ka ndërmarrja performancë të mirë, atëherë do të na raportojnë aksionarët, nëse nuk ka, atëherë do të shkojmë në diskutim dhe mund ta bëjmë edhe një hap të tillë. Në këtë kohë vlerësojë që është herët të formojmë një komision të tillë.

Muhamed Selmani theksoi se sa i përket formimit të këtij grupei punues, në qoftë se vjen një propozim vetëm prej dy anëtarëve, nuk besoj që mundet me qenë ndoshta edhe shumë valid, andaj dhe mendimi im është dhe i qëndroj shumë strikt kësaj pike, se kjo ndërmarrje është joprofitabile dhe kurrë nuk ka qenë profitabile prej themelimit. Për këtë arsyе duhet të shikohet

seriozisht funksionimi i saj dhe fuzionimi i saj me ndërmarrjen tjetër, që është "Pallati i Rinise" që e ka të njëjtin funksion.

Bahri Gashi tha se ne e përkrahëm kërkesën e znj. Bejta, por edhe propozimi i z. Boroci gjithashtu e përkrahim.

Fisnik Osmani tha se Kuvendi ka dërguar njerëz të cilët janë profesional dhe e kanë të qartë se çka duan të bëjnë me ndërmarrjen, nuk na duhen grupe të tillë punuese jo vetëm në "Sport Marketing", por edhe në ndërmarrjet të tillë ose të tjera në të ardhmen, pra dhe jemi kundër formimit të këtij grupi.

Fiknete Bejta shprehu mendimin se nëse krijojmë një komision tjetër, nuk jemi në gjendje të garantojmë që do të kemi një komision të ekspertëve dhe nuk e shoh të arsyeshme që ne vetëm të përziejmë kompetenca dhe të mos synojmë të arrijmë një rezultat fiks për atë cila është çështja që jemi duke diskutuar. "Sport Marketingu" mund të rigjallërohet vetëm me punën dhe vullnetin e komisionit të aksionarëve, prandaj dhe shoh një vullnet të mirë të komisionit të aksionarëve, ku për një kohë shumë të shkurtë mund të na sjellin ndryshimin e veprimtarive ekonomike.

Feim Osmani tha se komisioni i aksionarëve nuk na solli asnjë informatë, përveç kërkesës për subvencionim prej 150 mijë euro, e rritë nevojën për ta formuar dhe për ta krijuar një komision të tillë. Pikërisht kjo e shton nevojën të ketë komisione të tillë dhe të hulumtojmë mundësi që këto ndërmarrje ose t'i bëjmë profitabile, ose t'i shndërrojmë në diçka tjetër, t'i bashkëngjitet një ndërmarrjeje tjetër, ose t'i shuajmë tërësisht.

Endrit Zabërgja tha se ideja e formimit të këtij komisioni do të ishte dhënia e disa ideve që do të ishin në favor të ndërmarrjes, kështu që këtë e potencoi edhe z. Boroci, që hapësirat reklamuese ndoshta, funksionalizimin e pishinës së Gërmisë verës dhe dimrit, si patinazh etj., prandaj ne këtu të gjitha partitë kemi ide të ndryshme dhe formimi i një komisioni të tillë nuk e konsiderojmë që është organ i tretë, në fakt është organ rekomandues, ashtu siç edhe ne si opozitë po kërkojmë me qenë kështu.

Triera Kasumi- Berish shprehu mendimin se formimi i këtij komisioni nuk do të kishte bërë konkurencë ose pengues për aksionarët, kështu që unë jam shumë i thitare e asaj që të krijohet ky grup punues, i cili ka me qenë më shumë rekomandues, dhe i cili ka me dhënë shumë më shumë ndihmë sesa të bëjë pengesa.

Kushtrim Mushica theksoi se e përkrahim propozimin e z. Boroci, kështu që duke e ditur që ndoshta në asnjë mandat tjetër më herët nuk ka pasur ekspertë të fushës së sportit sesa që ka ky mandat, andaj mund ta jepim kontributin tonë pse jo vullnetarisht, pa e kontestuar edhe gjithë kapacitetet që i kanë komisionarët, sepse i njoh të gjithë dhe janë bashkëpunues dhe besoj që edhe ata e kishin mirëpritur një këshillë, një sugjerim nga një grup punues i mundshëm që mund të dalë nga ky Kuvend.

Kryesuesi konstataoi se më 23 vota për, 23 vota kundër dhe 2 abstenime (por duke pasur parasysh votën e dyfishtë të kryesuesit, i cili në këtë rast ka votuar kundër), nuk u miratua Propozimvendimi për themelimin e grupit punues për shqyrtimin e fushëveprintarisë së NPL "Sport Marketing";

Pika e njëmbëdhjetë Pyetje dhe përgjigje

Rashit Gashi, për drejtorin e Drejtorisë së Inspepcionit,

- Pjesa ku është pastruar te rr. "Tirana" përgjatë hekurudhës prapë ka filluar të mbushet me mbeturina, por besoj se duhet me pasur një kontinuitet të punëve atje për me e mbajtur në atë nivel ashtu si e keni pastruar, që mos të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Endrit Zabërgja, për kryetarin e Komunës

- Deri ku ka mbërrri procesi rreth vendosjen së shtatores së komandantit legjendar "Adem Jashari".

Arbër Vokrri, për drejtorin e Drejtorisë së Pronës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë

- Një ankesë e qytetarëve që ka të bëjë me shpronësim, kanë shpreh shqetësimin e tyre rreth pengesave për shpronësimin, ku dhe për këtë çështje kryetari i Komunës ka thënë se në fakt nuk ka kurrfarë bllokimi, janë të njëjtat procedura institucionale, por jemi duke tentuar me funksionuar më ndryshe se deri tash, kështu që këto procedura të shpronësimit duhet të bëhen prej një komisioni të veçantë e jo siç ka qenë deri më tanë prej një personi.
- Në QMF-të ka mungesë për barnat e listës esenciale, edhe kjo është vërejtur qe disa muaj e nuk po korrigohet, kështu që në mungesë të tyre, është i vështirë funksionimi i QMF-së.
- Sipas konceptit të mjekësisë primare nuk do të ishte dashur me pasur shërbime të mjekësisë familjare në ndërrim të natës po qe te ne ka, ku në këtë kuadër ka një disproporcione të madh të vëllimit të punës dhe numrit të personelit, ditën ka më pak punë e më shumë personel dukshëm më shumë në krahasim me natën kur ka më shumë punë e më pak personel.
- Në QMF-n 4 e cila mbulon 1/3 e Komunës, qe një vit mbasel edhe më shumë se një vit është në proces të rinovimit edhe ky proces nuk po përfundon. Ajo pjesë që është kryer pra me rinovim edhe marrësit e shërbimeve por edhe personeli janë të pa kënaqur thuhet se janë të cilësisë më të ulët të mundshme edhe flitet që një pjesë e mjeteve janë bartur për rinovim të QMF në Bardhosh, mendoj se është shkelje e procedurave.

Mirsad Vitia, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

- Banorët afër rrugës "Enver Gashi", kërkojnë që mundësish kjo rrugë të shtrohet me asfalt apo edhe me kubëza të betonit.

Triera Kasumi – Berisha, për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit

- Disa biznese të ilat operojnë brenda hapësirës së Parkut të Qytetit, dhe të cilat e kanë demoluar një pjesë bukur të mirë që është hapësirë e përbashkët me terasa dhe ndërtimë tjera ku kanë bërë edhe shtylla të betonit. Kërkoi të dijë se a ka ndonjë plan rrith asaj veprimtarie dhe si ka me qenë ecuria e operimit të këtyre bizneseve. Po ashtu kërkoi që brenda hapësirës së parkut të vendosën shumë sinjalizues, sepse ka shumë ankesa që lëvizjet e tepërtë dhe me shpejtësi të motoçikletave e rrezikojnë sigurinë e qytetarëve,
- Unë kam pyetje për kryetarin nëse kanë një plan konkret për këtë pikë sepse i kemi disa parqe, është konkretisht Parku i qytetit në të cilin operojnë disa biznese të cilat kanë abuzuar me hapësirat publike të parqeve duke i shndërruar hapësirat e gjelbra nëpër tarraca ku kanë bërë edhe shtylla të betonit edhe goxha e kanë shndërruar në një pamje të keqe krejt Parkun përveç që kanë abuzuar me kanë usurpuar hapësira të parkut,
- A ekziston një plan konkret se çfarë biznese do të licencohen se e dimë se në secilin park duhet me pasur shërbime të tillë, po qysh kanë me u licencuar, qysh kanë me qenë rregullat, a kanë me qenë biznese mobile të cilat lëvizin çfarë madhësie çka kanë me shërbyer,
- Një rekomandim, sa i përket komunikacionit meqë po bëhet njëfarë rishqyrtimi i krejt komunikacionit në qytetin e Prishtinës a keni ndonjë plan për shenjëzimin, për vendosjen e shenjave të komunikacionit për bicikleta dhe motoçikleta, sepse kohëve të fundit ne kemi një fluks goxha të madh të këtyre mjeteve që janë pjesëmarrëse në komunikacion edhe nuk e kemi asnje semafor e asnje vendkalim për to.

Gëzim Sveçla, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Sportit

- Në parkingun te stadiumi "Ramiz Sadiku" ka filluar ndërtimi i një objekti që duket se do të jetë autolarje, kërkoi të dijë se a është në kuadër të "Prishtina Parking" apo si është rasti me këtë objekt,
- Ndërmarjet si, "Termokosi", "Telekomi" apo "Ujësjellësi", me rastin e punimeve që bëjnë ato ndërmarrje, në masë po dëmtohet infrastruktura rrugore. Kërkoi që pa punimeve që bëhet rruga të sanohet dhe të kthehet ashtu si ka qenë më parë.
- Pyetja është se në vitin 2017 është arritur një marrëveshje në mes Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Federatës së futbollit të Kosovës edhe komunave të ekipeve të super ligës.

A ka ndonjë informacione a është duke lëvizur diçka rrith ndarjes së ndonjë parcele për ndërtimin e një fushë ndihmëse për Flamurtarin, pra ti sigurohet një fushë, për shkak se i gjithë klubit duke filluar prej akademisë së futbollit prej më të vegjëlve e deri tek ekipi i parë e kanë atë fushë të vet të cilën e përdorin.

- Kryetar, para nja dy jave ka qenë një eksperiment me trafikun në Prishtinë, a i keni përpunuuar të dhënat çka kemi përfituar prej atij eksperimenti, a mundemi
- Për këshilltarët e kabinetit, përmes Ligjit për qasje në dokumentet publike kemi kërkuar listën e këshilltarëve në kabinet, e kemi marr atë listë, mirëpo nga ajo që kemi parë ajo nuk përputhet me emërimet të cilat i keni bërë dhe i keni në web faqen zyrtare. Do të thotë listën të cilën e kemi marr ndryshon nga lista e emërimeve që ju e keni.
- Një ofertë, një tender prej 350 mijë eurove për qentë endacak tash së voni, a mundemi me e ditë se për çka është fjalë tash.

Feim Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- Kërkoi që rruga Besi – Rimanishtë të pastrohet prej shkurreve dhe degëve të tjera të drunjëve anash, pasi që shtrirja e tyre po e pengon lëvizjen e automjeteve, si dhe të nxënësve dhe të këmbësorëve.

Arbnora Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë

- Banorët e fshatit Prugovc kërkojnë që të rregullohet rrejti i kanalizimit për grumbullimin e ujërave atmosferike, ujëra të cilat mbledhen prej Bardhoshit vazhdon nëpër toka bujqësore e vjen deri tek magjistralja që lidh Malishevën dhe Lebanën, ku këta banorë çdo vit kanë probleme me vërvshime të shtëpive të tyre .
- Në listën e dokumentacioneve, te thirrja publike për dhënien e subvencioneve, a do të ishte mirë që mos të kërkohet vërtetimi i tatimit në pronë në momentin kur është bujku si aplikues, por pasi që të bëhet përfitues të dorëzoj këtë dokument.

Besart Krasniqi, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- Me rastin e zhvendosjes së Stacionit Policorë në lagjen "Kodra e Trimave",
- propozoj që në atë vend ku ka qenë Stacioni Policor të ndërtohet një park me hapësirë gjelbëruese sportive -rekreative, ku banorët e lagjes tonë do të mund të dalin me familjarët dhe fëmijët e tyre të argëtohen.
- Po ashtu propozoj që të ketë hapësirë të jetë një parking nëntokësor, për shkak se rruga kryesore ka mungesë të parkingjeve, e në këtë mënyrë edhe bizneset që janë në të pjesë janë dëmtuar jashtëzakonisht shumë, ku unë mendoj se do t'ia lehtësonte sado pak mënyrën e jetesës në atë pjesën tonë.
- Po ashtu banorët e fshatit Butovc ankohen për dëmtimin e rrugës Kavajë – Kolovicë – Butovc, që po ju bëhet nga automjetet e rënda të kompanive private që bartin dheun. Këta banorë kërkojnë nga Komuna që të bëhet një ndërhyrje në atë pjesë në mënyrë që të mos ketë probleme të tilla.

Nora Kelmendi, për kryetarin e Komunës

- Disa qytetarë të lagjës "Ulpiana" C3, rruga "Hendri Dynant", kanë kërkuar takim me juve për shkak që Termokosi e ka kyç hyrjen e tretë deri sa hyrja e parë dhe e dytë është anashkaluar dhe nuk është kyç. Ndoshta ju keni ndikim me biseduar me Termokosin ose me i pranuar në takim këta qytetarë.

Berat Lahu, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit,

- Ç'farë masa janë ndërmarrë, apo a do të ndërmirren për parandalimin e ndotjes akustike, ne veç tanë kemi filluar me pasur shqetësimë në lagje të ndryshme. Për të qenë në kontakt me drejtorinë e Inspektionit do të ishte më se e domosdoshme që të funksionon qendra e thirrjeve, ku qytetarët do të paraqiteshin shqetësimet e tyre, mirëpo kjo qendër nuk është duke funksionuar dhe ata janë të detyruar të thërrasin policinë.

Petrit Reçica, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit

- A do të ketë ndonjë kufizim për mbajtjen muzikës nëpër lokale, vetëm po dua me e dit që kjo çështje ku është për momentin a ka filluar me u ndërmarr diçka me e dit se deri kur kemi të drejtë me bërë muzikë.

Bahri Gashi, për kryetarin e Komunës

- Është një parking te QKUK-ja te hyrja, është një biznes aty, dua atë dijë se si është puna e atij parking dhe sipas një informacioni thuhet se Komuna i ka dhënë tokë, ose është njëfarë koncesioni.

Jeta Rafuna Hasani, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit

- A do të merret ndonjë masë edhe ndaj qenve të pronarëve të cilët ata i shëtisin nëpër hapësirat e parqeve të qytetit, duke mos qenë të lidhur dhe pa maska, kështu që konsideroi se kjo mënyrë e sjelljes së tyre i rrezikon edhe qytetarët të cilët i frekuentojnë këto parqe. Lidhur me këtë kërkoi të dijë se a do të bëhet ndonjë rregullore për këtë çështje.

Gëzim Mehmeti, për kryetarin e Komunës

- Çështja ka të bëjë me rrugën "Agim Ramadani" dhe unazës së brendshme. A do të merret parasysh punimi voluminoz i kompanisë së njohur nga Anglia "McC Megdonald", të bëhet një kahasim, sepse aty ka një simulim që është bërë nga Fakulteti Teknik. Kishte me qenë mirë me i marrë, po ashtu ka edhe matje diku tri vjeçare.

Për pyetjet dhe kërkesat e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Florian Dushi, drejtor.

Pika e njëmbëdhjetë
Të ndryshme

Feim Osmani, kërkoi të dijë nga kryetari se a ka ndonjë informatë rreth trafikut urban dhe ku ka ngecur çështja, kur e dijmë se më se 10 mijë banorë të Prishtinës privohen nga kjo e drejtë dhe nuk e kanë në shfrytëzim autobusin e trafikut urban, që shtresat më të ndjeshme janë studentët, nxënësit dhe të moshuarit.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Osmani, sqarime shtesë dha Përparim Rama, kryetar.

Gëzim Sveçla paraqiti kërkesën e banorëve të fshatrave Trudë, Lebanë, Besi, ku edhe përmes peticionit kanë shprehë shqetësimin e tyre sidomos rreth çështjes së 250 nxënës kryesisht të fshatrave Trudë dhe Lebanë të cilët shkollimin e ndjekin në fshatin Bardhosh. Fshati Trudë nuk ka shkollë të veten, ku nxënësit e ktyre fshatrave shkollimin e vijojnë në Bardhosh, andaj do të ishte mirë që për vitin e ardhshëm në planifikimin buxhetor të parashihet ndërtimi ndërtimin i një shkolle në Trudë, pasi që shkolla në bardhosh është tejet e ngarkuar me numër të madh të nxënësve.

Mbledhja përfundoi në orën 19:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina



Faqe21nga21